



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 61, datë 06.04.2021

“PËR

DISA KORRIGJIME GABIMI MATERIAL NË VENDIMET E LISTAVE TË PËRFITUESVE NGA GRANTI I RIKONSTRUKSIONIT DHE PROGRAMI I RINDËRTIMIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 112, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, si dhe në vijim të shkresave nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Komisioni i i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programet e procesit të rindërtimit, me nr. 43680 prot., datë 11.12.2020, nr. 43682 prot., datë 11.12.2020, nr. 4132 prot., datë 27.01.2021, nr. 4923 prot., datë 29.01.2021, nr. 852/1 prot., datë 29.01.2021, 2074/1 prot., datë 19.02.2021, nr. 2074/1 prot., datë 01.03.2021, nr. 10421 prot., datë 05.03.2021, nr. 13452 prot., datë 30.03.2021 dhe memos me nr. 13149 prot, datë 29.03.2021 dhe me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimet e listave të përfituesve nga granti i rikonstruksionit dhe programi i rindërtimit bëhen korrigjimet e gabimit material përkatësisht si më poshtë vijon:

1. Në vendimin nr. 73, datë 19.06.2020, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
2. Në vendimin nr. 81, datë 27.07.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Në vendimin nr. 98, datë 04.09.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.

4. Në vendimin nr. 146, datë 30.10.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
5. Në vendimin nr. 161, datë 10.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
6. Në vendimin nr. 6, datë 13.02.2021, të Këshilli Bashkiak, “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
7. Në vendimin nr. 16, datë 01.03.2021, të Këshilli Bashkiak, “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
8. Në vendimin nr. 74, datë 19.06.2020, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i grantit të rindërtimit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
9. Në vendimin nr. 174, datë 21.12.2020, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i grantit të rindërtimit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
10. Në vendimin nr. 97, datë 04.09.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i grantit të rindërtimit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
11. Në vendimin nr. 147, datë 30.10.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i grantit të rindërtimit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
12. Në vendimin nr. 6, datë 13.02.2021, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i grantit të rindërtimit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
13. Në vendimin nr. 8, datë 13.02.2021, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i grantit të rindërtimit”, bëhet ndreqja e gabimit material sipas listës nr. 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
14. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njërive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Z V / K R Y E T A R I

LUAN BREGASI